




PROGRAMI

E enjte, 12.3.2015

Ora 11:00-12:00

Nga Sarajeva në Donezk

Imagjinata mbi dhunën: Lirika mbi luftën
Bashkëpunëtorë: Boris Chersonskij, Faruk Šehić
Moderatore: Kateryna Stetsevyh
Përkthyes: Sofia Onufriev, Blažena Radaš
Organizator: Traduki

Boris Chersonskij nga Ukraina dhe Faruk Šehić nga Bosnia dhe Hercegovina, në shikim të parë, duken se kanë pak të përbashkëta. Përfaqësojnë breza të ndryshëm, vendet e tyre nuk janë fqinje dhe flasin gjuhë të ndryshme. Edhe biografite e tyre nuk takohen në pika të përbashkëta. E megjithatë autorin ukrainas dhe atë boshnjak i lidh përvoja e luftës dhe dhunës. Të dy e kuptojnë lirikën e luftës si një përpjekje, jo vetëm për të riprodhuar 'në çdo gërmë momentin e luftës' (Chersonskij), por edhe 'për të kapërcyer pavazhdimësinë midis jetës para dhe pas luftës, për të mbyllur një boshllëk mental dhe emocional' (Šehić).

Të dy autorët lexojnë nga kujtesa e tyre Missa in tempore belli. Panairë në kohë lufte (Chersonskij, 2014) dhe Distinktivë prej mishi (Šehić, 2011) dhe diskutojnë si mund të përshkruhen përvojat e luftës në formën e duhur.

12:30-13:30, Skena e Traduki-t

Mbi damarët mesdhetarë dhe venat ballkanike: Durrës

Zbulimi i një qyteti shqiptar mesdhetar

Bashkëpunëtorë: Arian Leka dhe Uwe Rada

Moderatore: Doris Akrap

Përkthyes: Anila Shuka

Organizator: Traduki, Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë

Shqipëria është ende vendi më misterioz i Evropës. Jo vetëm për shkak të izolimit të saj të gjatë dhe veçansive gjuhësore. Enver Hoxha dhe njëqind mijë bunkered tashmë përbëjnë një terminologji të fiksuar për shumë njerëz. Por si duket Shqipëria përtej këtyre figurave të mirënjohura?

Poeti dhe eseisti shqiptar, Arian Leka, i ka kushtuar një pjesë të madhe të veprës së tij artistike identitetit mesdhetar të Shqipërisë dhe qytetit të tij të lindjes, Durrësit. Uwe Rada, gazetar dhe autor, ka udhëtuar përgjatë bregdetit të Adriatikut në Itali, Kroaci, Mal të Zi, Bosnie dhe Hercegovinë dhe Shqipëri dhe ka shkruar një histori kulturore të Adriatikut dhe të Evropës (Adriatiku. Rizbulimi një vendi malli, 2014).

Doris Akrap moderon bisedën mbi Shqipërinë. Durrësin dhe Adriatikon dhe një “Evropë që rritet në qoshet e saj dhe jo nëpër kryeqytete”.

13-14, Cafe Europa, Salla 4, E 401

(Ri)zbulimi i zërit

Qytet. Protestë. Stamboll – Kiev – Sarajevë

Bashkëpunëtorë: Faruk Šehić, Baris Uygur, Boris Chersonskij

Moderatore: Azra Džajić Weber

Përkthyes: Blažena Radaš, Kateryna Stetsevyich, Selma Wels

Organizator: Traduki, Komisioni Evropian

Në “Qoshe të Evropës” qytetarët luftojnë për vlera evropiane

Protestat në parkun Gezi ishin një kryengritje kundër prekjes së hapësirës publike të Stambollit nga një qeveri gjithnjë e më autoritare, protestat në Maidan, reagimi i popullit të Ukrainës ndaj një regjimi të korruptuar thellësisht, i cili i bllokonte perspektivat drejt Evropës, dhe protestat në Sarajevë dhe Tuzla, kryengritja e banorëve të Bosnias dhe Hercegovinës kundër një krize të thellë socio-ekonomike dhe kundër elitave politike që e kanë prurë vendin në këtë krizë të përgjithshme.

Një bisedë mbi demokracinë, protestat dhe vlerat evropiane.

14-15, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Vende ukrainase në lindje dhe perëndim

Kiev dhe Charkiw

Bashkëpunëtorë: Tanja Maljartschuk, Saschko Uschkalow

Moderatore: Claudia Dathe

Përkthyes: Sofia Onufriev

Organizator: Traduki

Libri me tregime i Tanja Maljartschuk Lepuri dashakeq dhe evropianë të tjerë mbledh tekste që raportojnë mbi vetminë e njerëzve në Kiev. Shitëse, shoferë, punonjës në stacionin e trenit janë protagonistët e saj. Saschko Uschkalow i shkruan esetë e tij prej Charkivi mbi futbollin, infrastrukturën dhe fabrikat dhe vizaton kështu figurën e një metropoli modern evropian.

Autorët ndjekin gjurmët e së përditshmes urbane dhe krijojnë një mozaik të identitetit të qyteteve të tyre.

15:30-16:30 Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Një histori vjeneze: Motra e Freudit

Bashkëpunëtorë: Goce Smilevski

Përkthyes: Benjamin Langer

Moderator: Jörg Plath

Organizator: Traduki

Jeta e Sigmund Freudit ka mbetur totalisht në errësirë. Por, çfarë dimë për pjesën tjetër të familjes? Goce Smilevski pasqyron rrugën e jetës së Adolfinës, motrën e vetme beqare dhe pa fëmijë të Freudit, dhe kështu hedh edhe një dritë të re mbi jetën e vëllait të saj të famshëm. Kur Sigmundi 1938 emigroi në Londër, ajo mbeti në Vjenë me tre motrat e saj, u deportua dhe vdiq në Theresienstadt, 1943.

Motra e Freudit u nderua në 2011 me çmimin European Union Prize për letërsi dhe është përkthyer në mbi 30 gjuhë.

20, theater.FACT, Komedi e vogël në Barthels Hof, Hainstr.1, 04109 Leipzig

Të tregojmë historinë evropiane. Dhe ta përkthejmë

Moderatore: Claudia Dathe, Annemarie Türk

Përkthyes: Sofia Onufriev, Andrej Lovšin, Benjamin Langer, Blažena Radaš

Organizatorë: Traduki, TransStar Europa, Fondacioni Robert Bosch, Ministria e Kulturës e Kroacisë

Autorët e suksesshëm Kateryna Babkina (Ukrainë), Miha Mazzini (Slloveni), Milorad Popović (Mal i Zi), Goce Smilevski (Maqedoni), Vladimir Stojšavljević (Kroaci), Faruk Šehić (Bosnie dhe Hercegovinë), Ivana Šojat Kuči (Kroaci) dhe Saschko Uschkalow (Ukrainë) lexojnë historinë dhe historitë evropiane. Në gjuhën e vërtetë të Evropës, të përkthimit. Tinguj më pak të njohur ballkanikë të Atilla Aksoj dhe Jelena Milušić do ta shoqërojnë mbrëmjen.

E premte, 13.3.2015

11-12, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Një udhëtim drejt detit: Split

Bashkëpunëtorë: Nicol Ljubic, Marko Pogačar

Moderation: Uwe Rada

Përkthyes: Hana Čopić

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Kroacisë

“Ku është parë kjo, që një pallat romak bëhet epiqendra e jetës së përditshme? Që të banosh në shllafarinë perandorake ose të kërcesh tango në sheshin, ku ai u shfaqej vartësve të tij? ” pyeti veten autori gjerman Nicol Ljubić, i cili ka jetuar dhe punuar në Split si bursist i programit Writer-in-Residence “Marko Marulić”. “Ndoshta këtu në Split”, është përgjigjja e tij.

Prej pesë vitesh, programi Writer-in-Residence mirëpret shkrimtarë nga gjithë Evropa dhe ia paraqet ata publikut të interesuar në kafenetë dhe pijetoret e Splitit.

Poeti i ri kroat Marko Pogačar ka lindur ka jetuar gjithë jetën e tij në këtë qytet.

11-12, Forumi LindjJugLindje, Salla 5, E 505

Sarajevë, një takim kulturor

Autore të reja evropiane tregojnë mbi kryeqytetin e Bosnies

Bashkëpunëtorë: Barbi Marković, Miruna Vlada

Përkthyes: Jan Cornelius

Moderatore: Miranda Jakiša

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë

Barbi Marković është pa dyshim një nga zërat më interesantë dhe të veçantë të letërsisë bashkëkohore serbe. Si nomade moderne, jo vetëm që ajo endet midis Vjenës dhe Beogradit, por edhe ka gjetur një atdhe në shumë qytete evropiane, të paktën për një kohë të shkurtër. Me fenomenin e qytetit merret ajo prej shumë vitesh. Ajo ishte bursistja e parë e Writer-in-Residence në 2011, kur lindi ky program në Sarajevë dhe gjeti rrugën e saj të jashtëzakonshme për të përvetësuar qytetin.

Poetja rumune Miruna Vlada shkoi në Bosnie dhe Hercegovinë për të hulumtuar për dizertacionin e saj dhe kaloi gjashtë muaj në qytete të ndryshme të Bosnies dhe Hercegovinës. Libri i saj me poezi Bosna. Partaj (Bosnia. Një ndarje mallrash) që u botua në 2014, u vlerësua në Rumani. Poetja e re solli, nëpërmjet veprës së saj, një përvojë të re dhe të panjohur në hapësirën gjuhësore dhe kulturore rumune.

12:30-13:30, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Cirk familiar, Danilo Kiš

Një bisedë për shkrimtarin e madh evropian Danilo Danilo Kiš

Bashkëpunëtorë: Helmut Böttiger, Sasa Ilić

Moderator: Heinrich Detering

Përkthyes: Blažena Radaš

Organizatorë: Traduki

Me rastin e përvjetorit të 25-të të vdekjes së Danilo Kiš-it, u botuan në 2014 nga shtëpia botuese Hansel romanet dhe tregimet e tij më të rëndësishme në një kolanë. Në atdheun e tij jugosllav, ai luftoi fuqishëm për t'u bërë shumë shpejt një nga tregimtarët më të mëdhenj të letërsisë evropiane të pasluftës dhe një klasik modern. Me veprën e tij unike, Kiš shkroi kundër harresës dhe vdekjes.

Në triologjinë e tij Vuajtje të hershme – Kopsht, hi – Ora e rërës, të cilën vetë ai e ka quajtur cirk familjar, ai i ka bërë një monument babait të tij të vrarë në Auschwitz dhe kulturës së Evropës Qëndrore. Në Enciklopedia e të vdekurve që tani është ripërkthyer, ai betohet për idealin e një shkrimi të kujtesës, i cili ruan gjithkënd në veçanësinë e tij. Një varr për Boris Dawidowitsch shkaktoi asokohe një kontroversë letraro-politike, sepse Kiš e shkroi totalitarizmin komunist me mjetet stilistikore të epokës moderne.

“E megjithatë nuk mund t'i larohe mi të vërtetës që ai është një autor i Evropës qëndrore i standardeve botërore, të cilit nuk do t'i kishte shpëtuar çmimi Nobel sikur vetëm të kishte jetuar më gjatë”, shkruan Ilma Rakusa në pasthënien e saj. Në 2015, Danilo Kiš do të mbushte 80 vjeç.

13 – 14, Kafe Europa, Salla 4, E 401

T'i besosh Evropës

Evropa dhe Islami. Mbi përvojat dhe ngjashmëritë

Bashkëpunëtorë: Adisa Bašić, Arian Leka

Moderator: Rüdiger Rossig Përkthyes:

Hana Čopić, Anila Shuka Organizatorë:

Traduki, Komisioni Evropian

Islami dhe Evropa trajtohen shpesh si dy botë krejt të ndryshme. Por myslimanët, të krishterët dhe çifutët jetojnë prej shekujsh së bashku në pjesë të ndryshme të Evropës. Në Shqipëri dhe në Bosnie, një bashkëekzistencë fetare është tashmë normalitet. Kjo nuk do të thotë që bashkëjetesa do të kishte qenë gjithnjë konfliktuale, por konfliktet nuk kanë ndodhur vetëm për shkak të feve. Ateizmi i Enver Hoxhës në Shqipëri kërcënonte besimtarë të të gjithë besimeve njësoj, dhe në Bosnie myslimanët dhe të krishterët kanë qenë në çdo kohë si pjesë të problemit, ashtu edhe pjesë të zgjidhjes. Përsa i përket bashkëekzistencës fetare, Evropa mund të mësojë shumë nga jugperëndimi i saj.

14-15, Skena e Traduki-t

Hënë e plotë mbi Gezi

Një bisedë mbi Stambollin, pemët, protestat dhe lirikën

Bashkëpunëtorë: Branko Ćegek, Baris Uygur

Moderatore: Aylin Rieger

Përkthyes: Blažena Radaš, Selma Wels

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Binooki

Autori nga Stambolli Baris Uygur është një ndër shumë të rinj turq, të cilët ngritën zërin për demokraci në 2013 në parkun Gezi pranë sheshit Taksim. “Gezi i ka dhuruar Turqisë një utopi që ajo nuk e ka përjetuar kurrë. Ndoshta ishte hera e parë që qemalistët dhe kurdët, myslimanët dhe mbështetës të LGBT, anarkistët dhe trozkistët, kanë luftuar pranë njëri-tjetrit”, thotë ai në veprën e tij, e cila u botua në antologjinë letrare Gezi (Binooki, 2014) bashkë me tekste të 19 publicistëve, shkrimtarëve dhe fotografëve të tjerë.

Poeti nga Zagrebi Branko Ćegek kaloi një muaj në metropolin turk si bursant i Fondacionit S.Fischer. Ky qëndrim u solli lexuesve kroatë librin me poezi Pun mjesec u Istanbulu (Hënë e plotë mbi Stambollin), për të cilin kritika revanshoi me çmimin kroat “Kiklop”.

15:30 – 16:30, Skena e Tradukit, Salla 4, D 507

Qyteti si motiv letrar

Perspektivat nga Vaduzi dhe Bukureshti

Bashkëpunëtorë: Patrick Boltshauser, Ioana Parvulescu

Moderatore: Miranda Jakiša

Organizatorë: Traduki, Ambasada e Litenshtejnit në Berlin, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë

Katarakte quhet romani i autorit nga Lihtenshtejnit, Patrick Boltshauser. Bëhet fjalë për një djalë të ri të 20-tat që shkon në një qytet të huaj, humb atje në labirintin e rrugëve dhe rrugicave dhe konstaton që kjo humbje është pasqyrë e jetës së tij të brendshme. Katarakte është pjesa e parë e një triologjie mbi mungesën.

Romani i Ioana Pârvulescus Viața începe vinery (Jeta nis të premtën) është vlerësuar me European Union Prize për letërsi. Historia fillon me një djalë të ri, i cili gjendet pa ndjenja në periferi të Bukureshtit. Askush nuk e di kush është ai, dhe gjithkush ka nga një teori të ndryshme sesi ai ka përfunduar në atë gjendje. Romani tregon histori të shumë personazheve që ngatërrohen me njëri-tjetrin, por heroi i vërtetë i romanit është vetë qyteti i Bukureshtit.

E shtunë, 14.3.2015

11-12, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Prishtina nuk ka lumë

Një bisedë qytetare mbi kryeqytetin më të ri evropian

Bashkëpunëtorë: Ervine Halili, Saša Ilić

Përkthyes: Hana Čopić, Anila Shuka

Moderatore: Doris Akrap

Organizatorë: Traduki, Ambasada e Republikës së Kosovës

Dialogu letrar kosovaro-serb nisi pas një pauze prej disa dekadash në 2010 në panairin e librit në Leipzig. Sasa Ilić ishte një nga autorët e parë serbë që udhëtuan në kryeqytetin e Kosovës, dhe botuesi i antologjisë Përzemërsisht nga Beogradi nga autorë të rinj serbë, e cila u botua në gjuhën shqipe. Antologjia Përzemërsisht nga Beogradi erdhi edhe i përkthyer në serbisht nga autorë të rinj kosovarë. Ervina Halili përfaqëson gjeneratën më të re të autorëve kosovarë dhe ishte në 2014, në kuadër të një programi shkëmbimi serbo-kosovar Writer in Residence, në Beograd.

Dialogu letrar serbo-kosovar do të vazhdojë edhe këtë vit në Panairin e Librit në Leipzig. Si duket sot qyteti që dikur duhet të ishte qyteti i vëllazërimit dhe njësimi të Jugosllavisë?

11-11:30, Cafe Europa, Salla 4, E 401

Mbi “Vendi i Zi”

Bashkëpunëtor: Marko Pogačar

Përkthyes: Blažena Radaš

Moderator: Reto Ziegler

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Edicioni Korrespondencat

“Marko Pogačar është një mrekulli. Nuk është shumë e qartë se kush është ai, kush e ka zbuluar dhe pse, vetëm duket qartë që ai është mes nesh dhe është i domosdoshëm”, shkroi Tomaž Šalamun për kolegun e tij poet, të cilin shumë e quajnë “Rimbaud të poezisë kroate”. Me shumë libra me poezi të publikuar deri tani, Pogačar u bë për një kohë shumë të shkurtër figurë kyçe e skenës lirike të Evropës Juglindore.

Libri i tij më i ri Vendi i zi është një qasje sensuale dhe njëkohësisht e mprehtë me kushtet, në bazë të të cilave njeriu e fiton lirinë e tij. Historia, kështu tregon Pogačar, është detyra e gjithsecilit, diçka intime, për të cilën duhet luftuar – ajo është “hapësira poshtë thonjve”. Nga motivet e natës, zjarrit, erës, tymit, ziftit, Marko Pogačar thur një labirint të zyrtë rrëzëllitës të të tashmes.

12-13, Forum International, Salla 4, C503

Në qoshe të Evropës?

Një diskutim mbi marrëdhënien midis qendrës së Evropës dhe periferisë së saj

Bashkëpunëtorë: Saša Ilić, Dragana Tripković

Përkthyes: Hana Čopić

Moderator: Ulrich Ladurner

Organizatorë: Traduki, Komisioni Evropian

Në qendër qëndron pushteti. Por qendra jo domosdoshmërisht është vendi më i mirë për të përshkruar pushtetin. Për këtë, periferia është më e përshtatshme. Sepse në zonat në periferi të perandorive mund të vëzhgohen ndikimet e pushtetit me sy të lirë. Kështu mësojmë në Donbass të Ukrainës shumë për Moskën dhe në Evropën Juglindore mbi Bashkimin Evropian. Këtu, dridhjet që shkaktojnë ndryshime në qendër, ndihen më fuqishëm se askund tjetër.

12:30-13:30, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Drita e diellit - Enciklopedia e një qyteti

Bashkëpunëtor: Daša Drndić

Përkthyes: Blažena Radaš

Moderator: Jörg Plath

Organizatorë: Traduki, Hoffmann und Campe, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë

Një nënë pret të birin. 62 vjet më pare, ai është rrëmbyer nga nazistët nga Gorizia pranë Triestes. Kur ishte e re, ajo pati një historiçkë me një oficer të sigurimit. Ndryshe nga pjesa tjetër e familjes së saj çifute, ajo mbijetoi – dhe kërkoi për dekada me radhë djalin e saj. Gjatë kërkimit, ajo ndeshet me fate të tjera, shkruan dëshmi, sheh fotografi dhe copëza kujtimesh.

Daša Drndić tregon mekanizmat e së keqes, shpjegon sesi njerëz të zakonshëm bëhen kriminelë, dhe shkruan kundër harresës dhe mefshtësisë. Ajo përpiqet t'i afrohet sa më shumë asaj që mund të jetë e vërteta.

14-15, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Cila është Sarajeva e sotme?

Një bisedë qytetare.

Bashkëpunëtorë: Kathrin Schmidt, Dusan Šarotar, Adisa Bašić

Moderator: Ulrich Ladurner

Organizatorë: Traduki, Agjencia Sllovene e Librit JAK

1425 ditë zgjati rrethimi i Sarajevës nga ushtarët serbë dhe Evropa vështronte pa bërë zë. Qyteti dukej shumë larg, në periferi, përtej kufijve të kontinentit të vjetër. Njëzet vjet kanë kaluar nga koha e luftës. Po çfarë mund të na thotë Sarajeva sot mbi Evropën?

Adisa Bašić jeton në Sarajevë dhe shkruan për të. Atje, programi Writer-in-Residence mirëpret prej vitesh shkrimtarë nga Evropa. Autori slloven Autor Dušan Šarotar dhe shkrimtarja gjermane Kathrin Schmidt (në bashkëpunim me Institutin Goethe në Bosnie dhe Hercegovinë) janë dy prej bursantëve që u bënë pjesë e jetës së përditshme të Sarajevës dhe e konkretizuan qytetin në veprën e tyre.

15:30-16:30, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Krokodili në Savë: Beograd

Tre perspektiva të qytetit të bardhë

Bashkëpunëtorë: Marcel Beyer, Srđan Srdić, Franziska Wicke

Moderatore: Annemarie Türk

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Republikës së Serbisë

KROKODIL quhet shoqata e re kulturore, e cila drejton prej vitesh me sukses një Festival të Letërsisë si dhe programin Writer-in-Residence në Beograd. Kështu e vizitoi qytetin edhe shkrimtari gjerman Marcel Beyer në 2014 dhe e njohu atë gjatë qëndrimit të tij 1-mujor. Fotografja Franziska Wicke ka jetuar në kryeqytetin serb dhe ka fotografuar një Beograd të zejeve, çka së shpejti ndoshta do t'i përkasë të shkuarës. Srđan Srdić, autor i ri serb, fitues i shumë çmimeve, jeton në Beograd dhe shkruan mbi qytetin e tij.

20h, UT Connewitz, Wolfgang-Heinze-Straße 12A, 04277 Leipzig

Nata Ballkanike

Nata Ballkanike: shëtitje letrare dhe muzikore mes qytetesh të Evropës juglindore. Dhe disa hapa më tej.

Bashkëpunëtorë: Daša Drndić, Ervine Halili, Barbi Marković & diSTRAUKTURA, Tomislav Osmanli, Ioana Parvulescu, Gëzim Qëndro, Stefan Sprenger, Dušan Šarotar, Srđan Srdić

Përkthyes: Blažena Radaš, Anila Shuka, Benjamin Langer, Andrej Lovšin

Moderatore: Aylin Rieger und Hana Stojčić

Organizatorë: Traduki, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Shtëpia botuese Hoffmann und Campe, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Ambasada e Republikës së Kosovës në Berlin, Ambasada e Litenshtejnit në Berlin, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, JAK – Agjencia Sllovene e Librit

A keni qenë ndonjëherë në Bukuresht ose Sarajevë, në Beograd, Vaduz ose Tiranë?

Këtë vit, i ftuar është publiku i Leipzigut t'i jepet në natën tradicionale Ballkanike një turi letrar mes qytetesh të Evropës juglindore. Autorë nga Shqipëria, Kosova, Kroacia, Lihtenshtejnit, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe Sllovenia prezantojnë historitë dhe librat e tyre me vlera.

Atilla Aksoj dhe Jelena Milušić do ta mbushin natën me tinguj nga repertori shumëgjyresh i muzikës ballkanike të romëve dhe aromunëve, nga këngët popullore maqedonase dhe këngëve qytetare boshnjake, sevdalinkave.

E diel, 15.3.2015

11-12, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Absolutisht modern?

Referim dhe bisedë mbi kryeqytetin maqedonas, Shkupi

Bashkëpunëtorë: Tomislav Osmanli dhe Ksenija Čočkova

Përkthyes: Benjamin Langer

Moderatore: Nathalie Kronast

Organizator: Traduki

Shkrimtari maqedonas Tomislav Osmanli është një njohës i vërtetë i qytetit të Shkupit, të cilit ai i kushtoi një pjesë të madhe të veprës së tij. Romani i tij Dvaeset i prviot (I njëzetënjëti), të cilit iu dha çmimi i rëndësishëm ndërkombëtar i letërsisë. Ai edhe luan atje, në një qytet, ku të rinjtë luftojnë me varfërinë, mungesën e perspektivës, irracionalitetin politik, por edhe me ndjenjat e tyre vetjake.

Në Little Global Cities del në pranverën e 2015 një guidë turistike për Shkupin në një lloj të veçantë. Artistë të rinj maqedonas janë ftuar të përshkruajnë ato vende që ndodhen jashtë shtigjeve turistike. Përkthyesja Ksenija Čočkova e drejton projektin dhe tregon mbi përpjekjen për të fiksuar një qytet në tekste dhe fotografi.

12:30-13:30, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Vende ukrainase: Lemberg dhe Donezk

Bashkëpunëtorë: Petro Jazdenko, Wladimir Rafejenko

Moderatore: Claudia Dathe

Përkthyes: Sofia Onufriev

Organizator: Traduki

Askund nuk përplasen botët e jetës dhe vlerave në Ukrainë më fuqishëm se në Lemberg dhe Donezk – në përfundim qyteti kulturor galician me të shkuarën e tij habsburgase, në lindje reviera e qymyrit në industrializimin e kohërave sovjetike. Wladimir Rafejenko tregon në romanin e tij Demoni i Dekartit për Donezkun e erozionit të mitit të vjetër të industrisë, Jazenko shkruan te Saga e Lembergëve mbi ngatërresat e qytetit lindor galician në shekullin e 20-të. Së bashku, ata diskutojnë mbi forcën shpërthyesë të miteve në kontekstin e ndodhive aktuale në Ukrainë.

14-15, Skena e Traduki-t, Salla 4, D 507

Berlin, një vështrim nga jashtë

Bashkëpunëtorë: Sasa Ilić dhe Nataša Kramberger

Moderatore: Antje Contius

Përkthyes: Hana Čopić

Organizatorë: Traduki, JAK-Agjencia Sllovene e Librit

Kryeqyteti gjerman tërheq prej 25 vitesh magjishëm njerëz nga e gjithë bota. Nataša Kramberger, gazetare sllovene dhe autore me adresë në Berlin, është një

prej këtyre njerëzve dhe në librin e saj të botuar rishtazi, *Brez zida (Pa mur)*, ajo tregon historinë e Berlinit dhe histori berlineze.

Saša Ilić e shkroi romanin e tij *Berlinsko okno (Dritare berlineze)*, kur ishte bursant i Kolokiumit Letrar në kryeqytetin gjerman. Libri flet për kërkimin e një njeriu që është zhdukur gjatë luftës së Jugosllavisë dhe përfaqëson të gjithë të zhdukurit e luftës në 1990. *Berlinsko okno* është një roman i Berlinit dhe njëkohësisht një roman mbi kulturën e kujtesës.

Një bisedë mbi Berlinin e bukur dhe mbi faktin, pse ai është burim frymëzimi për autorë nga Evropa Juglindore.